REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 668/22
Datë/Datum. 08.02.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 668/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga, Agon Ramadani - Kryetar, Vedat Poterqoi - Anëtar dhe Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik,"Albi Company" sh.p.k, me seli në Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-renovimi i objekteve me vlera historike kulturore në qytetin e Prizrenit" me numër të prokurimit: 622-22-9594-5-2-1, iniciuar nga AK Komuna Prizren, më datën 06.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet** si e pabazuar, ankesa nr.668/22 e parashtruar nga operatori ekonomik,"Albi Company" sh.p.k, me seli në Rahovec, përkitazi, me aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtimi-renovimi i objekteve me vlera historike kulturore në qytetin e Prizrenit" me numër të prokurimit: 622-22-9594-5-2-1, iniciuar nga AK Komuna Prizren.

II. **Mbetet në fuqi**, njoftimit Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-renovimi i objekteve me vlera historike kulturore në qytetin e Prizrenit" me numër të prokurimit: 622-22-9594-5-2-1, iniciuar nga AK Komuna Prizren.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.

IV. OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/ L-068, dhe Ligjin 05/L-092.

V. Konfiskohet tarifa për ankesë e OE "Albi Company" sh.p.k, me seli në Rahovec, konfom nenit 31 pika 5 të rregullores së punës së OSHP dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 17.11.2022,ka pranuar ankesë nga OE "Albi Company" sh.p.k, me seli në Rahovec, përkitazi, me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-renovimi i objekteve me vlera historike kulturore në qytetin e Prizrenit" me numër të prokurimit: 622-22-9594-5-2-1, iniciuar nga AK Komuna Prizren, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 668/2022.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë. Vlera e parashikuar e kontratës: 150,000.00€.

Për aktivitetin prokurimit në fjalë Autoriteti Kontraktues me datën 31.10.2022,ka publikuar Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues B58, ku e ka shpërblyer me kontratë, OE"U-Unique" sh.p.k me seli në Prishtinë.

Me datë 07.11.2022,OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim, me datë 10.11.2022,AK- Komuna Prizrenit, e refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Albi Company" sh.p.k, dhe e ka vërtetuar aktivitetin e prokurimit të sipër shënuar.
Me datë 17.11.2022 OE "Albi Company" sh.p.k, me seli në Rahovec, ka parashtruar ankesë në OSHP.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët, OE nuk është pajtuar, ndërsa AK bazuar në shkresat e lëndës nuk është deklaruar lidhur me të njëjtin.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar eksperten vlerësuese në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 06.12.2022, ekspertja shqyrtuese ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues "Albi Company" sh.p.k, me seli në Rahovec të refuzohet si e pa bazuar,

- njoftim për Vendimin e Autoriteti Kontraktues -B58 të mbetet në fuqi dhe AK-ja të vazhdoj me këtë aktivitet të prokurimit sipas procedurave të përcaktuara në LPP-së

-Seanca dëgjimore

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura dhe rendësin e tyre:

- Ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar,
- të mbetët në fuqi njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe
- AK të vazhdoj më procedurë konfrom legjislacionit në fuqi.

-Konstatimet e panelit shqyrtues

Duke i analizuar pretendimet e ankuesit, përmbajtjen e tyre dhe raportin e ekspertit shqyrtues Paneli Shqyrtues konstaton se pretendimet ankimore të OE ankues klasifikohen si të pabazuara si dhe mbështetet në raportin e ekspertizës, kështu që arsyetimet e tij llogariten si arsyetime të PSH.

Paneli shqyrtues vlerëson se fillimisht si çështje përcaktuese që krijon lidhshmëri lidhur me disa pretendime ankimore të OE ankues është çështja e klasifikimit të natyrës së ngjashme të punëve/projekteve, e kontestuar nga OE ankues lidhur me disa pretendime si subjekt i kësaj ankese, lidhur me këtë, PSH konsideron se si pika përcaktuese në rastet kur AK nuk saktëson në kërkesa të DT dhe NJK se cilat kontrata/punë konsiderohen të ngjashme me aktivitetin konkret (duke dhënë shembuj), bazuar në rastet e kaluara që si rrjedhojë kanë pasur pretendime të ngjashme/njëjta, vendimmarrja sa i përket këtyre çështjeve është arritur duke analizuar punët që parashikohen të zbatohen, qoftë në paramasë apo projekt-dizajn të aktivitetit, e pastaj krahasimi i tyre me punët/aktivitetet e përcaktuara në kontratat e referuara si dhe aktivitetin përkatës, kështu që lidhur me rastin tonë, vlen të potencohet se aktiviteti i prokurimit titullohet: "Ndërtimi-renovimi i objekteve me vlera historike kulturore në qytetin e Prizrenit", si dhe kërkesa e AK-së në këtë rast është "Projektet e natyrës se kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara", andaj rrjedhimisht duke pasur parasysh analizimin dhe krahasimin e punëve të parashikuara si dhe mendimin e ekspertit shqyrtues, PSH konstaton që projektet e natyrës së ngjashme me këtë kontratë mund të konsiderohen edhe kontratat/projektet e ofruara që mbulojnë natyrën e punëve ndërtimore, për faktin se në përshkrimin e punëve tek kontratat e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë rezulton se përqindja më e madhe e punëve konsiston me punët ndërtimore, ndërsa në rastin konkret kontratat e ofruara janë të kësaj natyre, andaj PSH konstaton se në këtë rast AK ka bërë vlerësimin e ofertave konform legjislacionit në fuqi, përveç tjerash, nuk kemi të bëjmë me kërkesë ekskluzive të specifikuar në DT dhe NJK që punët e përfunduara të jenë vetëm restaurime të objekteve të trashëgimisë kulturore siç pretendohet nga OE ankues, andaj rrjedhimisht, paneli këtë pretendim te OE ankues konform raportit të ekspertizës e klasifikon të pa bazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore për menaxherin e OE-së se rekomanduar për kontratë z. Florim Istrefi, duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, nga PSH është evidentuar se OE i rekomanduar ka të prezantuar Diplomën, CV-në dhe disa letra reference, bazuar në këto, Paneli vlerëson se kërkesa e AK nuk ka qenë qenë 5 vite pas diplomimit por vetëm 5 vite përvojë pune,

kështu që pretendimin ankimor si dhe përgjigjen në ekspertizë të OE ankues PSH i klasifikon të pabazuara poashtu duke u bazuar në nenin 56 par 3, i cili saktëson se: *Tenderuesi, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*

Për më tepër vlen të theksohet se, në bazë të dokumenteve të dorëzuara OE i rekomanduar ka ofruar dëshmi me të cilën dëshmohet se plotësohet kërkesa mbi 5 vite përvojë pune edhe pas diplomimit, lidhur me këtë, PSH konsideron se referenca e z.Istrefi nga kompania "Astraplan shpk" është për pozitën menaxher ekzekutiv dhe tregon për angazhimin e z.Istrefi (përshkrimi në referencë përshtatet më kërkesat e AK-së, menaxhim i projekteve në të gjitha fazat e projektit, përfshirë fushën e inxhinierisë se ndërtimit dhe restaurimit), kjo referencë ishte e lëshuar në vitin 2016 (referenca dëshmon vitet 2009-2016), ndërsa kontrata ishte për pozitën e drejtorit dhe është nënshkruar me 04.01.2018 deri me 31.12.2022, ndërsa lidhur me natyrën e punëve të kontestuar nga OE ankues, PSH konstaton se kjo çështje është shtjelluar në arsyetimin si më lartë lidhur me pretendimin ankimor 1, kështu që aktivitetet e përshkruara konsiderohen si të ngjashme me aktivitetin përkatës.

Sa i për këtë pretendimit tjetër ankimor, nga dokumentet e ofruara nga AK, shihet se OE fitues ka prezantuar një listë prej 15 personave, ku 14 prej tyre kanë profesion që ndërlidhet me projektin, si dhe një kontabilist të cilat janë të bashkangjitura 12 kontrata, ndërsa kontrata e z. Florim Istrefit ishte tek vendimi për menaxher si marrëveshje e bashkëpunimit, ndërsa mungon vetëm kontrata e personit të dytë znj. Hamdije Idrizi Krasniqi në listë e dorëzuar, pra edhe këtë pretendim paneli e konsideron si të pa qëndrueshëm për faktin se kërkesa 3 është "Të ketë së paku 10 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës.", andaj rrjedhimisht edhe kjo kërkesë bazuar në dokumentacionin përkatës është plotësuar.

Sa i përket pretendimeve të OE ankues ndaj OE tjerë ofertues në këtë aktivitet, PSH konstaton se mbështetet në raportin e ekspertizës, kështu që përkundër faktit se në ankesën e tij OE ankues paraqet pretendime që veçse tanimë janë shtjelluar (lidhur me natyrën e ngjashme të kontratës) dhe pretendime që janë të bazuara (edhe sipas raportit të ekspertizës), për më tepër, edhe sikurse pretendimet tjera të ishin të bazuara, kjo nuk do të ndryshonte vendimmarrjen përfundimtare sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, që është mbetja në fuqi e vendimit të AK-së, kështu që me

qenë se aktiviteti nuk kthehet në rivlerësim, PSH konstaton se nuk do të trajtojë në detale pretendimet rreth dy OE ofertues me çmim më të lartë se OE ankues.

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna Prizren

1x1 OE "Albi Company" sh.p.k, me seli në Rahovec

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.